

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2016 PËR PROJEKTIN “PROGRAMI I INVESTIMEVE PËR SHPËRNDARJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE I”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së bashkëpunimit financiar 2016 për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”, nëpërmjet së cilës qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë një kredi të butë dhe një shumë financimi nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau* (KfW), për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

Objektivi i projektligjit është që t’i mundësojë Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen së bashku nga të dyja qeveritë, që të marrë nga KfW-ja, për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”, shumat e mëposhtme:

- Një kredi të butë nga KfW-ja, e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim në vlerë të përgjithshme deri në 30 000 000 (tridhjetë milionë) euro;
- Një shumë financimi prej gjithsej 2 000 000 (dy milionë) euro për masat e nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje të plotë me politikat e Këshillit të Ministrave për mbështetjen e sektorit elektroenergjetik, duke synuar përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rritjen e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike për klientët në Shqipëri.

Ky projektligj nuk është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por nisur nga rëndësia që paraqet ky financim për sektorin elektroenergjetik, e konsiderojmë të domosdoshëm ratifikimin sa më shpejt të tij.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji i mundëson Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, marrjen e një huaje me kushte të favorshme nga KfW-ja, për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”, në vlerën 30 000 000 (tridhjetë milionë) euro, në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim, si dhe marrjen e një shume financimi prej 2 000 000 (dy milionë) eurosh, për masat e nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit.

Në pikëpamjen strategjike, projekti do të ndikojë përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rritjen e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike për klientët.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është i bazuar në Kushtetutë, në pëputhje me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe është miratuar, në parim, me vendimin nr.695, datë 21.11.2018, të Këshillit të Ministrave.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit financiar 2016 për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”, nëpërmjet së cilës qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim, të marrë një kredi të butë nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau* (KfW), në vlerë të përgjithshme deri në 30 000 000 (tridhjetë milionë) euro, nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u

mbështetur dhe kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci për shlyerjen shtetërore në rast se ai vetë nuk është huamarrës. Ky projekt nuk mund të zëvendësohet nga projekte të tjera. Gjithashtu, qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që në kuadër të marrjes së masave të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të marrë një shumë financimi prej 2 000 000 (dy milionë) eurosh. Marrëveshja përmban 5 nene.

Mënyra e përdorimit të këtyre shumave, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedurat e dhënies së porosisë do të përcaktohen në kontratat që do të përfundohen ndërmjet KfW-së dhe marrësve të huas dhe shumës së financimit, të cilat i nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale Gjermane.

Marrëveshja parashikon zhvleftësimin e premtimit të shumave të përmendura në këtë marrëveshje, nëse kontratat përkatëse të huas dhe të financimit nuk lidhen brenda gjashtë vitesh pas vitit të premtimit. Afati për shumat e përmendura në këtë marrëveshje mbaron në datën 31 dhjetor 2022.

Marrëveshja gjen zbatim edhe në rast se qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme, i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga KfW-ja hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e këtij projekti ose masa të tjera të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit.

Sipas kësaj marrëveshjeje Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë në rastet kur ai vetë nuk është huamarrësi, do të garantojë ndaj KfW-së të gjitha pagesat në euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve, që mund të lindin në bazë të kontratave që do të lidhen në zbatim të pikës 1, të nenit 2, të kësaj marrëveshjeje.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj KfW-së të gjitha pagesat për shlyerjen e detyrimeve që mund të lindin në bazë të kontratave të financimit, të cilat do të lidhen në zbatim të pikës 1, të nenit 2, të kësaj marrëveshjeje.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë, në kontekstin e lidhjes dhe të zbatimit të kontratave që do të lidhen ndërmjet KfW-së dhe marrësve të huave dhe shumave të financimit, në zbatim të pikës 1, të nenit 2, të kësaj marrëveshjeje. Sipas marrëveshjes, tatimi mbi vlerën e shtuar, si dhe taksat e tatime të ngjashme indirekte që lindin në këtë kontekst mbarten nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Krahës kësaj,

Këshilli i Ministrave e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike.

Sipas kësaj marrëveshjeje, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjërëve dhe të furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, që rezulton nga dhënia e huave dhe e shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr, sipas rastit, lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe OSHEE, sh.a.-ja.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji i paraqitur nuk ka efekte shtesë financiare, megjithatë implementimi i projektit të parashikuar në marrëveshje do të sjellë efekte financiare që përfaqësohen nga normat minimale të interesit të aplikueshme nga huamarrësi, i cili do të disbursojë shumat për projektin, pas nënshkrimit të marrëveshjes së huas.

Marrëveshja e huas do të garantohet me garanci shtetërore nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rast se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë nuk është huamarrësi.

KËSHILLI I MINISTRAVE